



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2021:288570
Datë: 19.06.2024
Numri i dokumentit: 05837639

K.Dh.Shk II.nr.584/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbarimore të kreditorit Komisioni i Pavarur i Mediave, me seli në rr. "Perandori Justinian", nr.124, Prishtinë, kundër debitorit "Klan Kosova" me numër të regjistrimit të biznesit 70542943, me seli në zonën industriale, ish Fabrika e Amortizatorëve, Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1256/22 të datës 29.12.2023, me datë 19.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Komisioni i Pavarur i Mediave, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1256/22 të datës 29.12.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1256/22 të datës 29.12.2023, në dispozitiv të aktvendimit e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit "Klan Kosova" me numër

të regjistrimit të biznesit 70542943, ashtu që Urdhri Përmbarrimor P.nr.167/20, i lejuar me datë 12.08.2020, nga Përmbarruesi Privat Destan Bujupaj, është shfuqizuar.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, (*me pretendime sikur në ankesë*), për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përmbarrimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale me propozim që gjykata e shkallës së dytë, aktvendimin e ankimuar ta ndryshoj dhe çështjen ta kthejë në shkallë të parë në rivendosje.

Debitori nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Komisioni i Pavarur i Mediave, me seli në Prishtinë, ka paraqitur propozimin për përmbarrim bazë të dokumentit përmbarrimor – Vendim me numër Ref: 1910/1230/KPM/mf i datës 18.10.2019, me të cilën ka obliguar debitorin të paguaj në emër të borxhit të përcaktuar në shumë prej 3,000.00 €, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore dhe shpenzimet e tjera të krijuara në pajtim me UA-MD-së nr.06/2014, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm dhe pasojave ligjore.

Debitori, brenda afatit ligjor, ka parashtruar prapësim, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarrimor për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe për shkak se në asnjë fazë të procedurës borxhi nuk është bërë i kërkueshëm. Shton se nuk ka qenë njoftuar as verbalisht e as me shkrim në asnjë formë tjetër zyrtare apo private për plotfuqishmërinë e vendimit refuzues pas ankimit të debitorit ndaj gjobës së shqiptuar, për më tepër, për këtë lëndë si palë nuk janë të informuar menaxhmenti i ri drejtues i mediumit, i cili është funksional që nga muaji prill i viti 2020 e për të cilin është informuar zyrtarisht KPM-ja për ndryshimet në menaxhment. Gjykatës i ka kërkuar të aprovohet si i bazuar prapësimi i debitorit, të shfuqizohet

në tërësi Urdhri për Përmbartim, të kthehet procedura në gjendjen fillestare si dhe të detyrohet kreditori të dëshmojë se debitori në këtë rast ka pranuar vendimin refuzues të ankimit nga ana e debitorit, si dhe të dëshmojë nëse borxhi është bërë i kërkueshëm ndaj debitorit si dhe të detyrohet kreditori të paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore të parapara sipas UA.

Kreditore me përgjigje në prapësim, i ka kundërshtuar pretendimet e debitorit duke theksuar se i njëjti nuk ka parashtruar asnjë dëshmi me të cilën e argumenton se nuk ka borxh ndaj kreditorit dhe nuk bazohet në asnjë nga shkaqet e prapësimit të parapara me nenin 71 të LPP-së dhe si i tillë ky prapësim është i pabazuar. Gjykatës i ka kërkuar të refuzoj në tërësi prapësimin si të pabazuar dhe të ngelet në fuqi urdhri përmbartimor si dhe në rast se debitori parashtron ankesë ndaj aktvendimit të kësaj gjykate i njëjti të obligohet të paguaj garancion konform nenit 78 të LPP-së.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1256/22 të datës 29.12.2023, ku në dispozitiv të aktvendimit e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit “Klan Kosova” me numër të regjistrimit të biznesit 70542943, ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr.167/20, i lejuar me datë 12.08.2020, nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj, është shfuqizuar. Me arsyetim se Vendimi Ref:1910/1230/KPM/mf, nuk përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, pasi që në të njëjtin nuk është e përcaktuar koha e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore me rastin e vendosjes për aprovim të prapësimit të debitorit. Fillimisht propozimi për përmbartim është ushtruar në bazë të dokumentit përmbartimor i cili nuk i përmban tiparet e dokumentit përmbartimor të rregullt dhe nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm në procedurë përmbartimore ashtu siç parashihet me nenin 27 par.1 i LPP, i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë se Vendimi me numër Ref: 1910/1230/KPM/mf i datës 18.10.2019 si dokument përmbartimor mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmbartimore, respektivisht është lejuar përmbartimi nuk i plotëson kushtet mënyrë kumulative që duhet t'i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret qartë rezulton se Vendimi me numër Ref: 1910/1230/KPM/mf i datës 18.10.2019, nuk e përmban kohën e përmbushjes së detyrimit si element esencial për të qenë dokument i përmbartueshëm. Rrjedhimisht, në rast të mungesës së ndonjërit nga këto elemente dokumenti konsiderohet i papërshatshëm për përmbartim.

Gjykata Komerciale, dhoma e shkallës së dytë i ka vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore por të njëjtat kanë rezultuar si të pathemelta pasi që në këtë çështje juridike përmbartimore përmbartimi është lejuar në bazë të dokumentit i cili i nuk plotëson kushtet për përmbartim dhe nuk është i përshatshëm për përmbartim. Mirëpo kreditori mund të inicioj procedurë tjetër gjyqësore lidhur me realizimin e kërkesës së tij, varësisht nga suksesi nga ajo procedurë.

Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-DHOMA E SHKALLËS SË DYTË

K.Dh.Sh.II.nr.584/24 me datë 19.06.2024

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija-Ymeri